



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDIM**

Nr 71. Date 27/09 /2024

**Mbi Pranimin e të moshuarit Z.Ndoc Marku në Qendren e Përkujdesit Rezidencial për të Moshuarit "BESA", Barbullush**

*Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Bazuar në ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë; VKM-në 518, date 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar "Kreu III Pika 13,A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23,a; pika 24; Kreu IV "Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes" pika 58,ç; pika 59;" si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes social ekonomike të të moshuarit, me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, dhe Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak :*

**VENDOSI**

1-Pranimin e Z.Ndoc Marku me nr ID. D20725026G, në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush, duke i ofruar;

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social-Psikologjike.

2- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

3-Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektorit të Shërbimit Social.

**SEKRETARI I KESHILLIT**

**Ardian ÇELEPLJA**



**KRYETARI I KESHILLIT**

**Ervis SHIMAJ**

Miratuar me 19.....vota

Vota pro 19.

Vota kunder .....-

Vota Abstenim .....-

Zbardhur me date 02.10.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Vau Dejës, më \_\_\_\_\_ .2024

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 04 datë 09 . . 09 .2024

**"Për pranimin e të moshuarit z.Ndoc Marku në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" e ndryshuar, në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në vkm 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për perfituesit e shërbimit të organizuar " Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a); pika 24; Kreu IV " Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes " Pika 58, c) pika-59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

**PROPOZOJMË**

1-Pranimin në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush të z.Ndoc Marku me nr ID D20725026G duke i ofruar:

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social -Psikologjike

2. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike sipas paragrafit të parit 55 pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"i ndryshuar.

**I paraqitet Këshillit Bashkiak për të marrë vendimin**

**KRYETAR**  
**KRISTIAN SHKRELI**

**NE MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETAR**  
**Aleksandra Gjoni**

**Konceptoi:** Spec. Aurela Deda  
**Pranoi:** P/Sektori. Çuka Babani  
**Miratoi:** D/Drejtorie Ridvan Luzaku

**Konfirmoi Bazën Ligjore:** Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore

**Jurist** Erida Incha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. Prot.

Vau Dejës, me 2024

**RELACION**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 24, neni 55, pika 2 dhe 6; Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar " Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a); pika 24; Kreu IV " Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes " Pika 58, c) pika 59.

Mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës të z.Ndoc Marku për sistemimin e saj në qendren për të moshuar "BESA" Barbullush, ju paraqesim propozimin tonë për miratim nga ana juaj. Z.Ndoc Marku është shprehur se jeton i vetme prej disa vitesh, pasi bashkëshortja i ka vdekur. Nuk ka perkujdesje dhe as mbështetje. Jeton në një banesë me kushte minimale por ai ndjehet i braktisur dhe në kushte të vështira social-ekonomike. I gjendur në një situatë të tillë dhe i braktisur nga të afërmit kërkon që të sistemohet në një qendër të moshuarish pasi socializimi me të tjerë do bënte që të kalonte ditë më të qeta dhe më të lumtura.

Nisur sa më sipër Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr 13 datë 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinarë për vlerësimin e rasteve të personave që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqërore, komunitarë dhe rezidenciale publike dhe jopublike" bëri vlerësimin e dokumentacionit.

Nisur sa më sipër i moshuari Ndoc Marku plotëson kriteret sipas dokumentave dhe të dhënave :

- a) Certifikatë personale nga Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010
- b) Ceritfikaten Familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010

c) Fotografi të individit 2 (cope);

d) Raportin mjeksor që përcakton gjendjen shëndetësore

e) Vertetimi i gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas formularit të anketës me udhëzimin e ministrit të përgjegjës për çështjet sociale;

f) Vertetimi nga ZRPP-ja Aluizni për pronat që ka në zotërim;


g) Vërtetimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit; i marre me autorizimin përkatës të individit. (Ky verifikim do realizohet në vazhdim. Momentalisht mbështetemi në deklaratën e nënshkruar nga vetë i moshuari )


h) Kërkesë për azil.


Gjithashtu duke ju referuar dhe shqyrtimit të gjendjes social-ekonomike të të moshuarit Ndoc Marku të paraqitur nga administratori shoqëror sipas modelit formular përkatës ku rezultoi që i moshuari banon në një shtëpi me kushte minimale dhe në vështirësi ekonomike, është i vetmuar dhe pa përkujdesje nga asnjë njeri.

Në bazë të dhënave të mësipërme i propozojmë Këshillit Bashkiç, Bashkia Vau Dejës pranimin e të moshuarit në Qëndren e përkujdesit social për të moshuar "Besa " Barbullush.

#### Komisioni multidisiplinar i pranimeve

Edmond Gjeçaj  


Stefani Jaku  


Erolbe Geci  


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Vau-dejës

Njësia administrative Bushat

Zyra e Gjendjes Civile 338

CERTIFIKATË FAMILJARE

Data: 28.08.2024

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Data lindja | Gjendja Civile | Vendlindja          | Shtetësia | Numri Personal |
|-----|----------------|---------------|--------------|--------|-------------------------|-------------|----------------|---------------------|-----------|----------------|
| 1.  | Ndoc MARKU     | Gac           | Mrikë        | M      | Kryefamiljar            | 25-07-1932  | I/e ve         | Barbullush, Shkoder | Shqiptare | D20725026G     |
| 2.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 3.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 4.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 5.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 6.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 7.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 8.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 9.  | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |
| 10. | -----          | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----               | -----     | -----          |

Kjo certifikatë lëshohet për \_\_\_\_\_

Vulosur elektronikisht nga Drejtorja e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Date: 2024/08/28 09:26:13 +02:00  
16816965c930c14a882ee6682619d6

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA VAU DEJES  
QENDRA SHENDETSORE BARBULLUSH

VERTETIM

Vertetoj se zoti Ndoc Marku I ditelindjes 25.07.1932 me numer identifikimi D20725026G ka aftesi te kryej dherbimet vetjake. Eshte I semure kronik dhe trajtohet per diagnozen H.T.A. et koronari e potri

Leshohet ky vertetim sipas nevojave te intresuarit.

Dd. 29.08.24

Doktori i qendres shendetsore

Astrit Neziri

ASTRIT NEZIRI  
MIEK SHKOLLOR  
BARBULLUSH SHKOLLOR ALBANIA  
CEL: 0692184024

QENDRA SHENDETSORE  
BARBULLUSH  
SHKOLLOR


Datë 29.08.2024

## KËRKESË

Unë i nënshkruari Ndoc Gac Marku, me Nr.ID D207250266 banues në Barbullush, paraqes kërkesën time për t'u sistemuar pranë Qendrës së Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa". Barbullush.jam i moshuar ,pa mbeshtetje pa perkujdesje dhe në kushte të vështira.Kërkoj nga ana juaj qe te me asistoni ne strehimin tim ne qendren per te moshuar "Besa".

Fëmër/Mbiemër/Firmë

Ndoc Gac Marku



Cel: 0693272167